



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisoni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda:“Mbi miratimin e projekt dokumenteve të pikave të rendit të ditës”

- Mbi përdorimin e fondit të Shërbimit Social,mbështetje financiare e menjëhershme në raste të veçanta,Z.Behar Kuqi për të miturin K.K
- Mbi përdorimin e fondit të Shërbimit Social,mbështetje financiare e menjëhershme në raste të veçanta Z.Ali Hoxha për bashkëshorten Aurora Hoxha
- Mbi miratimin e kërkesës së Bashkisë Berat, së bashku me dokumentacionin tekniko - ligjor për akordimin e ndihmës financiare për familjen e z. Riza Keça, banesa e të cilit u dëmtua nga zjarri, nga buxheti i Bashkisë dhe nga buxheti i vitit 2025 në Ministrinë e Mbrotjtjes, programi “EmergjencatCivile
- Për ndryshim në vendimin e këshillit bashkiak Nr. 108 Datë 18.12.2024 “ Për miratimin e buxhetit të bashkisë Berat për vitin 2025 dhe PBA 2025-2027 ” (rialokim fondesh)”.
- Mbi miratimin e tavaneve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi per piken 1 dhe 2 mbështetet në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr. 597, datë 04.09.2019, e ndryshuar, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” vendimit nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, VKB-së nr.3, datë 27.01.2025 “Për miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok - ndihmën ekonomike deri në 6% dhe nga fondet e drejtorisë së Shërbimit Social”, VKB-së nr.108, datë 18.12.2024 “Per miratimin e buxhetit te vitit 2025 dhe PBA përfundimtare 2025-2027”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 4 pika 4, ligjin nr.121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, vendim nr. 518, datë 03.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”, ligjin nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, ligjin nr. 18/2017 “Për mbrojtjen të të drejtave të fëmijëve”

Per pikën 3 mbështetet në ligjin nr. 139/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8756 datë 26.03.2001 “Per Emergjencat Civile” i ndryshuar dhe VKM nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore

Per piken 4 dhe 5 mbështetet ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 40, pika 1, neni 41, pika c, 54, gërma “dh”, neni 64 gërma “c”, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, gërma “d”, neni 28, pika 5, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 24.01.2025 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore ” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 28.02.2025 “ Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028”, Udhëzimit Plotësues nr. 19 datë 10.07.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-20

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Pika 1 dhe 2 dhe 3 ka për qëllim ndihmën financiare për këto familje të cilat janë në kushte shumë të vështira si shëndetësore ashtu dhe ekonomike.

Pika 4 ka si qëllim miratimin e ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 108 datë 18.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat të vitit 2025 dhe PBA 2025-2027”, për rialokimin e fondeve

Pika 5 ka si qëllim të miratojë Tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet)

Për tre pikat e para akordohet një fond nga Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Emergjencave Civile për të ndihmuar njerëzit në nevojë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoritë e Bashkisë Berat dhe Njësitë Shpenzuese në varësi të saj.

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Drejtoritë e Bashkisë Berat dhe Njësitë Shpenzuese në varësi të saj janë kryesore në monitorim

Impakti social / grupet që preken:

Impakti Social është shumë i madh pasi të gjitha këto materiale prekin drejtpërdrejt individin dhe ndihmesën e tyre nëpërmjet fondeve të Bashkisë

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**”,shqyrtoi projekt vendimet e mësipërme .

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

- a. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
- b. Miratimin me shumicë votash të 5 pikave .

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar